



Kompania Rajonale e Ujësjetës Gjakova,Sh.A , duke u bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), nenit 4 paragrafi 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik shpall :

K O N K U R S

Titulli I Pozitës- Specialist/e në Nj. e Buxhetit dhe Planifikimit Financiar

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: Në kohë të caktuar/ Puna Provuese gjashtë (6) muaj në pajtim me Ligjin e Punës/ Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës :

- Analizon informacionin financiar (p.sh. të hyrat, shpenzimet dhe menaxhimin e parasë) për të siguruar që të gjitha operacionet janë brenda buxhetit;
- Nen udhëheqjen e Drejtuesit te departamentit jep buxhetet vjetore për menaxherët e lartë te kompanisë;
- Shqyrton kërkesate buxhetit për miratim;
- Parashikonvevojat e ardhshme buxhetore;
- Identifikon variacione midis rezultateve financiare aktuale dhe buxhetore në fund të çdo periudhe raportuese;
- Shqyrtoni buxhetin e kompanisë për pajtueshmërinë me rregulloret ligjore nëse ka;
- Harton dhe zbaton politikat efektive të buxhetit dhe procedurat;
- Propozon përmirësimin proceseve për zhvillimin e politikave që ndikojnë në mirëfunksionimin e aktiviteteve te kompanisë;
- Harmonizon buxhetin e Kompanisë me buxhetin i cili i dorëzohet Rregullatorit
- Çfarëdo detyre tjetër e caktuar nga KE-ja

Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe karakteristikat personale.

- Përgatitja profesionale/Shkollore- Diplomë universitare në Kontabilitet ose Financë;
- Përvojë 1 vjeçare që ndërlidhet me pozitën apo të ngjashme.
- Përdorues i aftë të paketës MS Office, ideale njohja e sistemeve te kontabilitetit dhe sistemeve të Informacionit.
- Njohja e dispozitave te raportimit Financiar.
- Aftësi shumë të mira në IT.
- Aftësi të mira organizative dhe koordinuese.
- Aftësi të mira komunikimi dhe të bashkëpunimit.
- Vërtetim nga gjykata që nuk është nën hetime.

Paga mujore: Sipas Rregullores.

Informata të përgjithshme :

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët që plotësojnë kriteret arsimore dhe profesionale sipas konkursit.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Procedura për aplikim- Aplikacioni (formulari) për konkurrim merret në Kompani dhe në ueb-faqen e Kompanisë, dhe të njëjtës i bashkëngjiten: 1. kopja e letërnjoftimit 2. Certifikata e lindjes, 3.CV-ja 4. Letër Motivuese/ kërkesë për punësim 5. kopjet e dokumentacionit të kualifikimit(kopja e noterizuar), si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit. Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati i konkurrimit është nga data: 04/11/2020 deri me 18/11/2020. Adresa e zyrës Rr"UÇK"Nr.7,50000-Gjakovë-Kosovë.

Vërejtje: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, ndërsa aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen .